

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 2.08.2024*

**2.08.2024  
Ora 13:03**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr.1 ID nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**


**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka prezent!
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme kemi në rend dite shqyrtimin e denoncimit nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për shkelje të pretenduara nga disa funksionarë publikë në Bashkinë e Himarës dhe dy projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë Has dhe në Këshillin e Bashkisë Elbasan. Mirë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Po, Madalena.

**Znj. M. Koja:** Mirëdita zoti Komisioner! Atëherë, sikundër është prezantuar në rendin e ditës, është administruar një denoncim i bërë nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër katër punonjësve të bashkive, respektivisht Vlorë dhe Himarë dhe Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Është një denoncim kundër z.Zambak Selmani, Drejtor i Infrastrukturës së Bashkisë Vlorë, z. Dorjan Demiri, Drejtor Juridik në Bashkinë Vlorë, z.Admir Malaj, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 2.08.2024*

Rrugor Vlorë dhe z.Meçan Myrtaj, Drejtor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Himarë. Pretendohet se këta katër punonjës, njëkohësisht dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë, kanë marrë pjesë në një aktivitet elektoral të kandidatit, z.Vangjel Tavo. Ky informacion i administruar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” është marrë nga faqja facebook e kandidatit. Sipas denoncuesit, rezulton se administrata e Bashkisë Vlorë dhe Himarë është angazhuar në veprimtari elektorale. Menjëherë kemi vënë në lëvizje procedurën administrative. Janë njoftuar palët për denoncimin e administruar, i është bërë me dije dhe denoncuesit komunikimi me palët, u është kërkuar shpjegime rreth fakteve dhe rrethanave në të cilat është zhvilluar ky aktivitet dhe nga sa kemi administruar dokumentacion dhe prapasime të palëve të denoncuara, ata pohojnë që kanë marrë pjesë në veprimtari të zhvilluara nga kandidati Vangjel Tavo, por këto veprimtari janë zhvilluar jashtë orarit zyrtar të punës, pasditeve përgjithësisht në disa njësi administrative të Bashkisë Himarë. Nga hetimi ynë administrativ konstatojmë që aq sa provohet nga postimi në faqen facebook të kandidatit, veprimtaria është zhvilluar në datën 22 korrik 2024. Referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor mbi afatet proceduriale rezulton se fushata zgjedhore për këto zgjedhje fillon në datën 27 korrik, pra, nuk jemi në periudhën e fushatës zgjedhore, sikundër imponon Kodi Zgjedhor, ndalime mbi pjesëmarrjen e punonjësve brenda orarit zyrtar, në fushatë zgjedhore. Në këto kushte ne vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj pesë të denoncuarve dhe të mos konstatohet shkelja administrative. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Ne i kemi zhvilluar të gjitha komunikimet në lidhje me rastin dhe nuk kemi patur, përfshi dhe denoncuesin...

**Znj. M. Koja:** Denoncuesin...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. I. Celibashi:**...shtesa në pretendime apo të tjera.

**Znj. M. Koja:** Pretendimet e palëve u janë bërë me dije edhe denoncuesit dhe nuk ka pasur pretendime ekstra nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, mbi sa pohohet nga apo prapësohet të denoncuarit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord! Atëherë, meqenëse, edhe sikurse ju relatuat jemi në kushtet kur kjo veprimtari është zhvilluar jashtë periudhës të përcaktuar me vendimin e Kolegjit Zgjedhor si periudhë për zhvillimin e fushatës zgjedhore. Me këtë rast, pavarësisht faktit nëse veprimtaria e tyre apo veprimet e tyre vijnë apo nuk vijnë në kundërshtim me ligjin, mendoj që nuk është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të shqyrtuar nga pikëpamja ligjore cilësinë e kësaj veprimtarie për sa kohë ajo veprimtari është zhvilluar jashtë fushatës elektorale. Neni 91 i Kodit Zgjedhor e përcakton, paragrafi 1, pika 1 dhe pika 2, e përcakton qartë, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatit të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor apo çdo lloj enti tjetër, ku shteti zotëron kapital apo kuotat ose edhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrativ të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Pika 2 thotë, në kuptim të këtij neni, burime quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil si dhe ato burime, si dhe çdo burim tjetër njerëzor i institucionit. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore si dhe përdorimi i detyruar e tjera, e tjera. Kështu që ndalimet lidhen me fushatën zgjedhore, jashtë kësaj fushate mund të jetë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 2.08.2024*

kompetencë e institucioneve të tjera vlerësimi i shkeljeve të rastit, nëse ka të tilla.

Kështu që do të vendosim:

- Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Zambak Selmani, Drejtor i Infrastrukturës në Bashkinë e Vlorës, z.Dorjan Demiri, Drejtor Juridik në Bashkinë Vlorë, z.Meçan Myrtaj, Drejtor i IMT-së Himarë, z.Admir Malaj, Drejtor i DRSHTRR-së Vlorë, z.Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë. Për moskonstatim të shkeljes administrative, rezultatet e këtij vendimi i njoftojmë palës së interesuar edhe nëpërmjet postës elektronike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Vendimi nr. 167**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.2.08.2024*

2.08.2024

Ora 13:10

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Has dhe Elbasan”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Mema.

**Parti Politike:** S’ka prezent!

**Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi** Mirë, kalojmë te dy çështjet e tjera që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë.

**Znj. P. Doçaj:** Këshilli i Bashkisë Elbasan, Këshilli i Bashkisë Has kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këshillat bashkiakë përkatës. Në referim të nenin 164, të Kodit Zgjedhor, nga ana jonë është proceduar me verifikimin e kandidatit vijues nga lista shumëemërore e subjekteve zgjedhore përkatëse. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion edhe nga Zyra e Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore. Në përgjigje të këtij rezultati, rezultojnë se kandidatët nuk kanë vendime penale të formës së prerë në ngarkim të tyre. Nisur nga këto verifikime dhe në mbështetje dhe të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstatojmë se të dhënat e kandidatëve nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë e tyre në këto funksione. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimet për miratimin tuaj.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.2.08.2024*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë miratojmë:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Has, me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialdemokrate” znj.Blerina Çela.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, znj. Areta Kumria.

Çështje të tjera nuk kemi. Mirë, seanca mbyllet. Faleminderit! Ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 161, 162.**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

